

Ariana Gaçi ka lindur në Tiranë, më 13.04.1973, dhe ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1995, si dhe Master i Nivelit të Dytë “Menaxhim”, pranë Universitetit European të Tiranës.

Aktualisht zonja Gaçi mban pozicionin e Këshilltarit të Kabinetit të Kryetarit, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë prej datës 05.04.2022.

Gjatë viteve 2017-2020, zonja Gaçi ka ushtruar detyrën e drejtorit të DTSH-së, ku ka përfaqësuar këtë drejtori në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe administrative të saj.

Gjatë viteve 2014-2017, zonja Gaçi ka ushtruar detyrën e Këshilltarit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë ku, ka kryer studime të çështjeve gjyqësore, përgatitje të relacioneve përkatëse, analizim të praktikës gjyqësore mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim.

Gjatë viteve 2009-2014, zonja Gaçi ka ushtruar detyrën e Teknik-Specialist-Ekspert në SHSA.

Gjatë viteve 2008-2009, zonja Gaçi ka ushtruar detyrën e Inspektore në Ministrinë e Drejtësisë, ku ka përgatitur rekomandime lidhur me masat ligjore dhe organizative për funksionimin e pushteti gjyqësor, kontrollin dhe inspektimin e gjykatave në vend.

Gjatë viteve 2007-2008, zonja Gaçi ka ushtruar detyrën e Specialistes në Sektorin e Hartimit të Legjislacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, pranë Ministrisë së Drejtësisë, ku ka hartuar projektligje, akte nënligjore në fushën e drejtësisë dhe/ose në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë viteve 1995-2007, zonja Gaçi ka ushtruar disa detyra si specialiste në Ministrinë e Punëve dhe Çështjeve Sociale dhe Bashkinë Tiranë.

Zonja Gaçi gëzon njohjen e legjislacionit; njohjen e teknikes legjislative për hartim dhe draftim legjislacioni dhe aktesh juridike me karakter të përgjithshëm dhe/apo dy ose më shumë palëshe; përfaqësimin gjyqësor në çështje civile, administrative, penale dhe të marrëdhënieve të punës, si dhe mbi negocimin si nocion i ndërmjetësimit.